



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Ilir Konushevi", nr.8 ♦ Prishtinë ♦ Kosovë Tel: ++381 38 500 400 0 Fax: + 381 38 248 076 E-mail:  
[info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org) [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Agjencia Kosovare e Privatizimit (tani e tutje: "Agjencia"), duke u bazuar në nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), nenin 68, pika 5,6 dhe 7, të Ligjit, nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë, dhe nenin 10.3, të Politikave Operacionale të Agjencisë, publikon:

**LISTËN PËRFUNDIMTARE TË PUNËTORËVE**

**Të cilët i kanë plotësuar kriteret për përfitimin e një pjese të të hyrave prej 20% nga privatizimi/likuidimi i NSH "Barnatoret e Prishtinës" (PRN068), Fi 670/74 në Prishtinë, si në vijim:**

Mbiemri	Emri	Vite pune	Mbiemri	Emri	Vite pune	Mbiemri	Emri	Vite pune
Ali	Musa	22.57	Helshani	Sevdije	26.49	Maksut	Guner	13.06
Asllani	Gjezide	15.37	Hoxha	Ganimete	27.34	Mustafa	Elheme	28.53
Bajraktari	Bashkim	23.96	Huruglica	Hasan	14.83	Prestreshi	Sofije	22.57
Balic	Mubera	22.52	Hykolli	Naim	29.33	Prestreshi	Emine	31.44
Balidemaj	Besa	13.78	Ibrahimi	Nazmi	23.90	Puka	Shpresa	30.52
Bokshi	Lumturije	25.46	Ibrahimi	Basrije	27.21	Qeshmegjiu	Ekrem	22.98
Emini	Visar	9.88	Janjeva	Durije	30.41	Restelica	Minire	13.46
Fusha	Xhavit	20.16	Jonuzi	Margarita	25.33	Shabani	Nevzije	26.44
Gashi	Ali	25.60	Kajtazi	Esma	22.52	Shala	Fatime	22.57
Gashi	Naxhije	26.49	Kastrati	Teuta	27.65	Uka	Driton	21.41
Gjata	Sulltane	32.11	Krasniqi	Raif	23.90	Vezaj	Sedlla	28.38
Hajzeri	Suzan	31.94	Llugaliu	Basrije	27.95	Ymeri	Hanife	18.06
Havolli	Luljeta	14.83						

Çdo punëtor cili mendon se ai/ajo do të duhej të jetë përfshirë në Listën Përfundimtare të Punëtorëve, apo çfarë do pretendimi tjetër ankimor lidhur me publikimin e kësaj liste, mund të parashtojë ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin prej 20 ditëve nga dita e publikimit të listës në përputhje me dispozitat e theksuara në hyrje të Listës (e nenit 68, pika 5, dhe 7, të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.)

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim dhe të përmbajë: (1) emrin dhe mbiemrin e parashtruesit të ankesës, (2) adresën e parashtruesit/parashtruesve të ankesës dhe (3) faktet ligjore në mbështetje të ankesës. Kopjet e dokumenteve duhet të jenë të vërtetuara nga organi kompetent në përputhje me ligjin.

Në rast se ankesa parashtrohet në emër të ushtruesit të ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati), atëherë ai/ajo duhet të prezantojë autorizimin e vërtetuar me shkrim për të ndërmarrë veprime juridike në emrin e tij/saj.

**Të gjitha ankesat në lidhje me këtë njoftim duhet të dorëzohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës deri më datën 27.09.2014 para përfundimit të orarit të punës**

Adresa:

**Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rr. "Nazim Gafurri "nr. 31  
10000 Prishtinë,  
Kosovë**



**AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO**

Rr. "Ilir Konushevc",nr.8 ♦ Prishtinë ♦ Kosovë **Tel:** ++381 38 500 400 0 **Fax:** + 381 38 248 076 **E-mail:**  
[info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org) [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Agjencia Kosovare e Privatizimit (Agjencia), Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KSHALP), duke u bazuar në dispozitat e nenit 68.2, 68.5 dhe 68.7 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 04/I-033, dispozitat e nenit 10.4 të Politikave Operacionale të Agjencisë, dhe dispozitat e nenit 4.2 të Rregullave të Procedurës të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve, pas shqyrtimit të ankesave të parashtruara nga ankuesit lidhur me mospërfshirjen e emrave të tyre në listën e përkohshme të punëtorëve me të drejtën e përfitimit të një pjese prej 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH " Barnatoret e Prishtinës" në Prishtinë, Komisioni Shqyrtues i Listave të punëtorëve më datë 26.08.2014 merr këtë:

## **V E N D I M**

**I. REFUZOHEN SI TË PABAZUARA** ankesat e Shpresa Krasniqi, Sutkije Stavilevci , Sadete Prekazi, Sasa Stefanovic , Ljubica Nikolic , Mirjana Vojvodic, Nada Vujacic, dhe ankesa e përbashkët e punëtorëve: Ekrem Qeshmaxhiu, Musa Aliu, Ali Gashi, Naxhije Gashi, Naim Hykolli, Nevzije Shabani, Visar Emini, Besa Balidemaj, Lumturije Bokshi, Sofije Prestreshi, Mubera Balic, Sevdije Helshani, Emine Prestreshi, Raif Krasniqi, Hasan Huruglica, Suzana Hajzeri, Shpresa Puka, Luljeta Havolli, Sulltane Gjata dhe Fatime Shala.

**A r s y e t i m**

Në bazë të dëshmime të dorëzuara me ankesën, Komisioni për Shqyrtimin e ankesave të Listave të Punëtorëve, konsideron se ankuesit në vijim nuk i plotësojnë kushtet për kualifikim për tu përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve, sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime)

#### **A. Libreza e Punës është e mbyllur**

Parashtruesja e ankesës Shpresa Krasniqi, ka dorëzuar kopjen e Librezës së Punës ku shihet se Libreza e Punës është mbyllur dhe se punëtorja nuk ka qenë e punësuar në NSH në kohën kur ajo është privatizuar.

Sipas nenit 69 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës ("Gazeta Zyrtare e RS" nr. 29/90, 42/90, 28/91) që konsiderohet së është Ligj në fuqi, sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 në lidhje me Legjislacionin në fuqi, Libreza e Punës është një dokument publik i cili përmban të dhëna relevante në lidhje me fillimin dhe përfundimin e punësimit.

#### **B. Nuk kanë mundur të vërtetojnë vazhdimësinë e punësimit të tyre në NSH.**

Parashtruesit e ankesës: Sasa Stefanovic, Ljubinka Nikolic, Mirjana Vojvodic-Cukalovic dhe Nada Vujacic kanë dorëzuar kopje të vërtetuar të Librezës së Punës që kanë qenë akoma të hapura. Megjithatë, parashtruesit e ankesës nuk kanë dorëzuar dëshmi të mjaftueshme në bazë të të cilave KSHALP do të mundë të vërtetonte vazhdimësinë e punësimit të tyre në NSH pas dt. së hapjes së LP, apo ndonjë dëshmi tjetër për të dëshmuar se parashtruesit e ankesës kanë ndërmarrë veprime juridike të nevojshme që të verifikojnë statusin e tyre nga marrëdhënia e punës deri në kohën e privatizimit të NSH.

#### **C. Ankesat me dëshmi të pamjaftueshme**

Parashtruesit e ankesës- kundërshtimit të përbashkët: Ekrem Qeshmaxhiu, Musa Aliu, Ali Gashi, Naxhije Gashi, Naim Hykolli, Nevzije Shabani, Visar Emini, Besa Balidemaj, Lumturije Bokshi, Sofije Prestreshi, Mubera Balic, Sevdije Helshani, Emine Prestreshi, Raif Krasniqi, Hasan Huruglica, Suzana Hajzeri, Shpresa Puka, Luljeta Havolli, Sulltane Gjata dhe Fatime Shala nuk i mbështesin ankesat- kundërshtimet e tyre të përcaktuar me dispozitat e nenit 10, pika 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2003/13, (me ndryshime) dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi që e rregullojnë këtë çështje administrative. Andaj AKP konsideron se pretendimet e ushtruesve të ankesës- kundërshtimit konsiderohen si të pabazë.

#### **D. Parashtruesit e ankesës që janë pensionuar para privatizimit**

Parashtruesit e ankesës: Sutkije Stavilevci dhe Sadete Prekazi në kohën e privatizimit kanë qenë në moshën mbi 65 vjet, sipas ligjit në fuqi ato kanë arritur moshën e pensionimit.

**KËSHILLA JUDIRIKE:**

Kundër këtij Vendimi mund të ushtrohet ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për Çështjet e Ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në Prishtinë, në afatin prej 20 ditësh, nga dita e publikimit të këtij vendimi.

**KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË LISTAVE TË PUNËTORËVE**